REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS-MINISTARSTVO OBRAZOVANJA I NAUKE-MINISTRY OF EDUCATION AND SCIENCE
DALJE
Njësia org. 01
Data/Datum/Date 26.11.2026
Nr. Prot./Br./No. 6764
Nr. i faq./Br.str/No.pg. 3
Prishtinë / Priština / Pristina

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Arsimit dhe Shkencës / Ministarstvo Obrazovania i Nauke / Ministry of Education and Science
Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

Numër: 01-6764
Data: 26-11-2026

Ministri i Arsimit dhe Shkencës, në mbështetje të neneve 8, 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06 / L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta zyrtare nr. 7/01 mars 2019), paragrafit 1.5 të nenit 11 të Ligjit për Qeverinë e Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare nr. 34/18 nëntor 2022), vendimit të Qeverisë nr. 02/270 të datës 07.10.2025, lidhur me mbështetjen e qytetarëve të Republikës së Kosovës në kuadër të Pakos së Ringjalljes Ekonomike, vendimit të Qeverisë lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike nr. 13/19 të datës 14.07.2021, të ndryshuar dhe plotësuar me vendimin nr. 12/31 të datës 25.08.2021, vendimin nr. 01/49 të datës 17.12.2021, vendimin nr. 15/62 të datës 23.02.2022, vendimin nr. 04/90 të datës 26.07.2022, vendimin nr. 31/99 të datës 30.09.2022, vendimin nr. 20/140 të datës 26.04.2023,vendimin nr. 23/159 të datës 13.09.2023 dhe vendimin nr. 19/11 të datës 16.11.2026, nxjerr këtë:

VENDIM

Mbi caktimin e kushteve dhe kritereve për zbatimin e pjesshëm të Masës 3.8 - Bursa e mobilitetit për studentët në kuadër të Pakos së Ringjalljes Ekonomike

1. **Subvencionimi**
   1.1. Të drejtë aplikimi për bursën e mobilitetit për studentët në kuadër të masës 3.8 kanë të gjithë studentët në nivelin Bachelor në institucionet e arsimit të lartë publike apo private të akredituara në Republikën e Kosovës, të cilët përmbushin kriteret sipas pikës 2 të këtij vendimi.

2. **Kushtet e subvencionimit**
   2.1. Mbështetja financiare sipas pikës 1 të këtij vendimi bëhet në formën e pagesës mujore, sipas kalendarit akademik.
   2.2. Aplikuesit duhet të plotësojnë kriteret si në vijim:
      2.2.1. Të jenë studentë aktivë dhe të rregullt në nivelin Bachelor në institucionet e arsimit të lartë publik apo privat të akredituar;
      2.2.2. Të jenë duke vijuar semestrin akademik për herë të parë dhe të mos kenë vit të

përsëritur të studimeve;

2.2.3. Të kenë të ardhura familjare jo më shumë se dymbëdhjetë mijë euro (12,000.00€) bruto në vit.

2.3. Subvencionimi i bursës së mobilitetit bëhet në bazë të distancës (në kilometra) së vendbanimit të aplikuesit nga universiteti ku i njëjti ndjek studimet.

2.3.1. Bursa e mobilitetit subvencionohet si në vijim:

2.3.1.1. Zero (0) deri në njëzet (20) kilometra distancë, shuma e subvencionimit është tridhjetë euro (30 €);

2.3.1.2. Njëzet e një (21) deri në pesëdhjetë (50) kilometra distancë, shuma e subvencionimit është pesëdhjetë euro (50 €);

2.3.1.3. Më shumë se pesëdhjetë (50) kilometra distancë, shuma e subvencionimit është shtatëdhjetë euro (70 €).

3. **Mënyra e aplikimit**

3.1. Aplikimi për bursën e mobilitetit për studentët bëhet përmes aplikacionit elektronik në platformën e-Kosova.

3.2. Aplikimi do të jetë i hapur nga data 26.11.2026 deri më 10.12.2026.

3.3. Aplikimet të cilat përmbajnë të dhëna të pasakta do të refuzohen dhe humbasin të drejtën për të përfituar nga bursa e mobilitetit.

4. **Procesi përzgjedhjes**

4.1. Për zbatimin e mbështetjes financiare sipas pikës 1 të këtij vendimi, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, përmes një vendimi të veçantë, themelon në kuadër të saj një Komision për përgatitjen e listave të përfituesve.

4.2. Komisioni sipas pikës 4.1. të këtij vendimi, ka të drejtë t'i saktësojë kriteret dhe kushtet për përfitimin e bursës së mobilitetit, si dhe, nëse paraqitet e nevojshme, të kërkojë dokumente shtesë.

4.3. Komisioni, sipas pikës 4.1. të këtij vendimi, do të bëjë verifikimin e listave në bashkëpunim me institucionet e arsimit të lartë të akredituara në Republikën e Kosovës, përmes databazës së të dhënave të ofruara prej tyre.

4.4. Komisioni, sipas pikës 4.1. të këtij vendimi, bën verifikimin e të ardhurave familjare sipas pikës 2.2.3. të këtij vendimi në bashkëpunim me Administratën Tatimore të Kosovës dhe Ministrinë për Punë, Familje dhe Vlera të Luftës Çlirimtare.

5. **Mbikëqyrja**

5.1. Komisioni, sipas pikës 4.1. të këtij vendimi, në bashkëpunim me institucionet e arsimit të lartë të akredituara në Republikën e Kosovës, do të bëjë verifikimin e listave dhe monitorimin e përfituesve të mbështetjes sipas pikës 1 të këtij Vendimi, përmes databazës së të dhënave të ofruara nga IAL-të, me qëllim të konstatimit të përmbushjes së kushteve akademike për kalimin në semestrin e dytë dhe vazhdimin e përfitimit të mbështetjes nga kjo skemë.

6. **Pagesat**

6.1. Pagesat për përfituesit e mbështetjes sipas pikës 1 të këtij vendimi, realizohen në llogaritë personale bankare në baza tremujore.

7. **Hyrja në fuqi**
   7.1. Obligohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e plotë të këtij vendimi.
   7.2. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Vendimi u dërgohet:
1. Kabinetit të Ministrit/MASH;
2. Sekretarit të përgjithshëm të MASH;
3. Drejtorit të përgjithshëm të Thesarit;
4. DALSH/MASH;
5. DBF/MASH;
6. Arkivit të MASH.

Hajrulla Çeku

Ministër i Arsimit dhe Shkencës